



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.64/2016

Prishtinë, më 4.7.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca, anëtarë, dhe Nuredin Ibishi, deputet, anëtarë i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Munguan: Glauk Konjufca, Fatmir Rexhepi, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Habib Hasani - MI; Jeton Rexhepi - PK; Fjolla Uka – KDI; dhe Dardan Abazi - INDEP.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.6.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28. 6. 2016

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 28.6.2016, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, lidhur më këtë pikë të rendit të ditës, tha se po e vazhdojmë shqyrtimin e raportit me amendamente të projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor nga amendamenti 202, ku kemi mbetur, duke i propozuar amendamentet një nga një.

Raif Qela, si kryesues i Grupit punues, duke prezentuar amendamentet në fillim sqaroj se nuk ka sesi të mos ketë kaq shumë amendamente, përderisa në këtë Projektligj të sjellë nga Qeveria, përveç gabimeve teknike, drejtshkrimore e të sintaksës, që janë me qindra, ka edhe formulime të llojit të tillë, si në Nenin 5, ku fjalë për fjalë thuhet: “dispozitat e parkimit të këtij ligjit.” Formulime të tilla hutuese e të paqarta dhe gabime të tilla nuk na lejohen, sepse do të ishte turp për ne si Grup punues dhe si Komision, por edhe për Kuvendin, nëse organi më i lartë legjislativ i këtij vendi nxjerr një dokument, në këtë rast, një Ligj, me formulime të tilla të palogjikshme dhe me aq shumë gabime. Në këtë pjesë të amendamenteve pra nga nenet 201-263, si dhe neni 4, Grupi Punues i ka ndryshuar dispozitat e propozuara të projektligjit të sjellë nga Qeveria lidhur me këto çështje:

- Në nenin 210, shoferit, i cili është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në aksident dhe i cili largohet me mjet nga vendi i aksidentit, përveç gjobës në të holla, shqiptimit të masës mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit me veprim motorik, ia kemi rritur prej tri, në pesë, pikët negative që duhet t’i shqiptohen. Sepse konsiderojmë se ky është gabim tepër i rëndë.
- Në nenin 231 paragrafi 5., shoferit, i cili e drejton mjetin me veprim motorik pa e pasur të drejtën për ta drejtuar mjetin, përveç gjobës në të holla, shqiptimit të masës mbrojtëse ndalimit të të drejtuarit të mjetit me veprim motorik, ia kemi zvogëluar prej pesë, në tri, pikët negative që duhet t’i shqiptohen. Sepse konsiderojmë se ky është gabim i rëndë, por nuk është prej gabimeve fatale.
- Në nenin 249 paragrafi 4., kemi përcaktuar që pika negative të fshihet nga evidenca e shoferit vetëm pas kalimit të dy vjetëve kalendarike nga data kur me vendim të plotfuqishëm është shqiptuar ajo pikë. Këtë formulim e propozova unë, sepse konsideroj që është e palogjikshme zgjidhja e deritashme dhe ajo e propozuar prej Qeverisë, e cila mundëson që pas dy vjetësh t’i fshihen të gjitha pikët negative të grumbulluara. Ky formulim i ri nuk lejon që dikush të grumbullojë, p.sh. në muajin e 24-të 8 pikë dhe me automatizëm t’i fshihen ato, dhe menjëherë pas kësaj në muajin e parë të llogaritjes së re t’i grumbullojë edhe 8 pikë të tjera negative. D.m.th., nuk lejon që dikujt të mund t’i shqiptohen 16 pikë negative në afatin prej dy muajsh apo në afat edhe më të shkurtër e të mos i shqiptohet masa mbrojtëse ndalim i të drejtuarit të mjetit.

- Në nenin 254, paragrafi 6., i hapet rruga Ministrisë për punë të brendshme që të krijojë mekanizëm për inkasim të gjobave, përmes nxjerrjes së një vendimi me akt nënligjor.
- Në nenin 255 paragrafi 6., kryesi i kundërvajtjes i cili e paguan gjobën në të holla brenda tetë (8) ditësh do ta paguajë vetëm gjysmën e gjobës së paraparë për kundërvajtjen e shkaktuar. Por nga Grupi punues nuk është pranuar propozimi në paragrafin 7 të këtij neni, të Projektligjit të sjellë nga Ministria, që të zmadhohet gjoba nëse ajo nuk paguhet brenda afatit prej 8 ditësh. Prandaj, GP e fshiu vazhdimin e këtij paragrafi me tekstin: *“sipas rrezikshmërisë së kundërvajtjes zmadhohet gjoba se paku për gjysmën e gjobës së paraparë për kundërvajtje deri tridhjetë (30) euro, përkatesisht deri në trefishin e sanksionit të përcaktuar për gjobat mbi tridhjetë (30) deri gjashtëdhjetë (60) euro.”*
- Përderisa në nenin 256, ministria përkatëse për Punë të Brendshme përcaktohet si institucioni i cili e mban evidencën e shoferëve në databazën përkatëse për shqiptim të masës mbrojtëse, për pikët negative dhe për aksidentet e trafikut, në nenin 257, p.4., dispozitat për mënyrën e evidencës etj., i mbajnë ministria përkatëse për Punë të Brendshme, në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e jo me Ministrinë e Drejtësisë, siç ka qenë teksti bazë i Projektligjit i sjellë nga Qeveria.
- Në nenin 259 paragrafi 1., polici në vendin e shkaktimit të kundërvajtjes të mund të shqiptojë gjobë me të holla deri në 60 euro (deri më tani ka qenë deri në 40 euro), ndërsa gjobat e parapara mbi këtë shumë procedohen në gjykatën kompetente.
- Në Nenin 263, Shfuqizimi i neneve, i janë shtuar edhe referencat në këto nene që nuk kanë qenë të përfshira në Projektligjin bazë të qeverisë (sepse ishin harruar) e që duhet të shfuqizohen: neni 260, neni 261, neni 269, neni 282 dheneni 294.

Deputeti **Raif Qela**, tha se tha se në këtë pjesë të Projektligjit që jemi duke e shqyrtuar, Grupi Punues ka pasur mendime të ndara në këto çështje: në nenin 206 p. 1.1 se a t’i lejohej apo jo shoferit të mjetit me përparësi kalimi dhe të mjetit nën përcjellje, ta lërë motorin të ndezur gjatë parkimit brenda zonës së banuar; në nenin 207, se si quhet pajisja rezervë e mjeteve të mëdha, për t’u siguruar që mjeti të mos lëvizë vetvetiu nga pozicioni i parkimit në përpjetëza të mëdha. Në këtë pajisje e kemi quajtur pykë sigurorese; në Nenin 217 pas daljes në vendin e aksidentit, a duhet të jetë Policia e obliguar të bëjë raport mbi aksidentin edhe atëherë kur kalon rastësisht aty dhe nuk thirret enkas? në Nenin 249, për mbajtje të evidencës së pikëve negative, a duhet Gjykata përkatëse të nxjerrë aktgjykim apo vendim? në nenin 258, paragrafi 2, lidhur me formulimin dhe me kohëzgjatjen: “Me qëllim që të sigurohet ekzekutimi i dënimit ose i masës mbrojtëse, gjegjësisht për shkak të sigurisë në procesin e kundërvajtjes, personi i autorizuar mund t’ia marrë shtetasit të huaj përkohësisht pasaportën, gjegjësisht ndonjë dokument tjetër, në kohëzgjatje deri në tri (3) ditë dhe të njëjtë i lëshohet dëshmi për marrjen e dokumentit të udhëtimit; në Nenin 262 paragrafi 1., a duhet që afatet për nxjerrje të akteve nënligjore nga autoritetet kompetente për zbatim të këtij ligji të jenë brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, apo në afat më të shkurtër? Prandaj, për këto çështje kërkohet vëmendje e Komisionit, tha Raif Qela.

Amendamenti 202

Neni 201, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 203

Neni 202, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 204

Neni 203, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 205

Neni 204, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 206

Neni 205, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 207

Neni 206, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 208

Neni 207, riformulohet.

Raif Qela tha se ne si grup i punës nuk kemi qenë të sigurt më fjalën e fundit “pyka” në nenin 207, paragrafi 3.

Pas debatit Komisioni ra dakord që fjalës “pyka” t’i shtohet fjalia “e sigurimit të mos lëvizjes”.

Amendamenti 209

Neni 208, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 210

Neni 209, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 211

Neni 210, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 212

Neni 211, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 213

Neni 212, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 214

Neni 213, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 216

Neni 215, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 217

Neni 216, riformulohet.

Deputeti Nuredin Ibishi propozoi që të ndryshohet titulli i nenit 216 si vijon: “Shikimi dhe ekzaminimi në vendin e ngjarjes” pasi që ishte kundër që të mbetet vetëm fjala “ekzaminim”.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Ibishi.

Amendamenti 218

Neni 217, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 219

Neni 218, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 220

Neni 219, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 221

Neni 220, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 222

Neni 221, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti

223 Neni 222, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 224

Neni 223, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 225

Neni 224, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 226

Neni 225, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 227

Neni 226, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 228

Neni 227, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 229

Neni 228, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 230

Neni 229, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 231

Neni 230, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 232

Neni 231, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 234

Nenet 233 dhe 234 iu ndërrohen vendet dhe riformulohen.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 235

Neni 235, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 236

Neni 236, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 237

Neni 237, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 238

Neni 238, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 239

Neni 239, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 240

Neni 240, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 241

Neni 241, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 242

Neni 242, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 243

Neni 243, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 244

Neni 244, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 245

Neni 245, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 246

Neni 246, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 247

Neni 247, riformulohet.

Blerim Grainca tha se këtë ide e kam kundërshtuar edhe në mbledhjen e kaluar, pasi që kjo dispozitë i shkel të drejtat e njeriut.

Sala Berisha - Shala propozoi që të gjendët një formë tjetër, si p.sh. të kushtëzohet më regjistrimin e automjetit.

Raif Qela tha se këtu nuk është fjala për konfiskim të dokumentacionit në kuptimin që e potencon z. Grainca, por kur shoferi është i paaftë fizikisht dhe psikisht dhe kjo ndalesë është derisa të zgjatë kjo paaftësi.

Komisioni, pas debatit vendosi fjala “Konfiskim” dhe të zëvendësohet me fjalën “Marrja”.

Amendamenti 248

Neni 248, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 249

Neni 249, riformulohet.

Raif Qela tha se edhe këtu kemi pasur dilemë si grup pune që në këtë rast gjykata nxjerr “aktgjykim apo vetëm vendim” si dhe evidencën e pikëve negative.

Besim Beqaj propozoi që në vend të fjalës “aktgjykim të jetë vendim” dhe evidencimin e mban secili institucion në bazë të kompetencës dhe kjo parashihet edhe në dispozitat e tjera.

Komisioni e përkrah propozimin e z. Beqaj.

Amendamenti 250

Neni 250, riformulohet.

Sala Berisha – Shala - propozoi që në nenin 250 në paragrafin 1, të ndryshoj afatin nga “dy në një vit” masa mbrojtëse për patentë shofer ndaj personit që ka bërë kundërvajtje në drejtimin e mjetit pa e fituar të drejtën e vozitjes.

Komisioni e përkrah propozimin e znj. Berisha - Shala.

Amendamenti 251

Neni 251, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 252

Neni 252, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 253

Neni 253, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 254

Neni 254, riformulohet.

Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 255

Neni 255, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 256

Neni 256, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 257

Neni 257, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 258

Neni 258, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 259

Neni 259, riformulohet.

Raif Qela e njoftoi komisionin se te neni 259, paragrafi 1, në pjesën e dytë të paragrafit duhet të bëjmë një ndryshim, si vijon: ”Kundërvajtjet më gjobë të parapara mbi këtë shumë procedohen në gjykatën kompetente.”

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Besim Beqaj propozoi që paragrafi 2 i shtuar të neni 259 të fshihet, sepse është i panevojshëm, kur dihet se të hyrat derdhen në buxhet të shtetit.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Beqaj.

Amendamenti 260

Neni 260, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 261

Neni 261, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Amendamenti 262

Neni 262, riformulohet.

Muhamet Mustafa propozoi që në nenin 262, afati për nxjerrjen e akteve nënligjore të shkurtohet nga “një vit” në “gjashtë muaj”.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Mustafa.

Amendamenti 263

Neni 263, riformulohet.
Amendamenti u përkrah nga Komisioni.

Raif Qela, në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës, kërkoi që në bazë të konkluzionit të mbledhjes së kaluar t'i kthehen nenit 3 apo amendamentit 4, ku është shtuar një përkufizim i ri si vijon: "1.64. "raporti evropian i aksidentit" dokument publik i cili përdoret gjatë shkaktimit të aksidenteve në trafikun rrugor me dëme të vogla materiale, i cili lëshohet nga organi kompetent;". Si dhe: fjala "automobil" fshihet në nënparagrafin 1.6; fjala "kombinim mjetesh" fshihet në nënparagrafin 1.10; fjala "automjet" zëvendësohet me fjalën "mjet" në nënparagrafin 1.39 dhe 1.43.

Komisioni e përkrahu propozimin e z. Qela.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet raporti me amendamente i Projektligjit nr.05/L-088 për Rregullat e Komunikacionit Rrugor.*
- 2. Raporti t'i procedohet Komisioneve të përhershme sipas procedurës.*

4. Të ndryshme
Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa